



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 149

Ora: 11:15

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 73, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”
përfaqësuar nga z. Zef Bushati

OBJEKT: 1. Kundërshtimi i vendimit nr. 196, datë 18.05.2023 i KZAZ nr. 80 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit të bashkisë Gjirokastër”. 2. Rinumërim dhe rivlerësim të



votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshillin për QV 4242, 4262 dhe 4310, në ZAZ nr. 80, bashkia Gjirokastër. 3. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin për këshillin e bashkisë Gjirookastër duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

BAZË LIGJORE: Nenet 123/1 dhe pika 2 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votive, KZAZ-të përkatëse plotësuan dhe miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për kryetarët e bashkive dhe për këshill bashkiak. KZAZ nr. 80, bashkia Gjirokastër ka miratuar vendimin nr. 196, më datë 18.05.2023, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit bashkiak Gjirokastër”.
2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 196, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 80, bashkia Gjirokastër, si dhe ka kërkuar rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshillin për QV 4242, 4262 dhe 4310, në ZAZ nr. 80, bashkia Gjirokastër.
3. Kërkesa ankimore nr. 73 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvin Lako. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 24.05.2023, ora 14:00. Në seancën e datës 24 maj 2023 ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, si dhe përfaqësuesi i palës ankimuese z. Zef Bushati, bashkë me z. Florian Duro, me autorizim.

4. Përfaqësuesi në seancë i ankuesit, z. Zef Bushati u shpreh në KAS se konteston vlerësimin e votave, në 3 QV, përkatësisht në QV 4242, 4262 dhe 4310. Për të mbështetur pretendimet e tij, ankuesi kërkoi nga KAS pezullimin e shqyrtimit për të patur kohë për tu pajisur me pamje filmike nga procesi i numërimit të votave. Në seancën e datës 24 maj 2023, trupa e KAS përbëhej nga katër anëtarë, dhe u ndodh në pamundësi për shkak të mungesës së kuorimit të nevojshëm për të vendosur mbi kërkesën e bërë nga ankuesi për pezullimin e shqyrtimit dhe marrjen e pamjeve filmikë nga KQZ. Në këto kushte, KAS vendosi pezullimi e hetimit dhe riçeljen e tij në datën 26.05.2023, në orën 11:00, duke i lënë kështu afat ankuesit të paraqiste kërkesë pranë KQZ-së për pajisjen me pamjet filmike nga procesi i numërimit të votave.
5. Seanca e datës 26.05.2023 u zhvillua në praninë e trupës së plotë të KAS, administratës së KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj. Përfaqësuesi i palës ankuese, i njofuar rregullisht, nuk u paraqit në seancë.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 73, datë 22.05.2023;
 - Vendimin nr. 196, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 80, bashkia Gjirokastër “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit bashkiak të bashkisë Gjirokastër”;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim

që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi.

2. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë ipso lege kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njeh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave “për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”.
3. Pika 1, e nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative saktëson: *“në procedurat administrative të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”*. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve *“të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”*.
4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se *“KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”*. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.

5. Kodi Zgjedhor e pranon rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave vetëm për vota të caktuara dhe vetëm në rrethana tejet specifike. Vota të caktuara janë, sipas pikës 3 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, *“votat e identifikuar ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi”*. Kjo do të thotë se numërimi dhe/ose vlerësimi i votave duhet të jenë shoqëruar me kontestime apo me konstatimin e pasaktësive, për to duhet të jenë bërë shënimet përkatëse në fletët e kontestuara, në tabelën e rezultateve të kontestuar apo në librin e protokollit të KZAZ-së, me qëllim që ato të mund t’i nënshtrohen procedurës së rinumërimit dhe/ose rivlerësimit.
6. Rinumërimi *“për shkak të rezultatit të ngushte të ndarjes së mandateve dhe numrit të lartë të votave të pavlefshme”* nuk është i parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe kërkesa nuk mund të plotësohet nga KAS-i. KAS-i në kuadër të procedurës për marrjen dhe kqyrjen e provave mund të hapë kutitë dhe të verifikojë vërtetësinë e fakteve nëpërmjet rinumërimit dhe/ose rivlerësimit, por te faktet shqyrtimin duhet ta sjelle pala pjesëmarrëse në procedurë nëpërmjet provave që paraqet. Ankuesi ka ngritur pretendime për *“tabelim të gabuar”* vetëm për QV nr. 4242, 4262 dhe 4310.
7. Duke mos u paraqitur në seancën e shqyrtimit të datës 26 maj 2023, megjithë njoftimin e tij rregullisht, pala nuk arriti të sjellë asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të veta për rezultatin në këto QV. Në seancën e datës 26.05.2023, administrata e KQZ pohoi se subjekti ankues nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë KQZ për pajisjen me prova - materiale filmike të procesit të numërimit të votave.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “c” dhe 143, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 73, datë 22.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 196, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 80, bashkia Gjirokastër “ Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Gjirokastër”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 24.05.2023.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar